



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 4

Prishtinë, më 11 mars 2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Teutë Hadri, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Armend Zemaj, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina, Mimoza Ahmetaj, Rita Hajzeraj dhe Sllobodan Petroviq .
Ndërsa mungoi: Bujar Bukoshi.

Të pranishëm ishin:

Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale : Agim Millaku, Murat Vokshi,

Fadil Rracaj, Fehmi Ibrahim, Leonora Zylfijaj .

Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri

Nga OSBE- ja: Petrit Hysa

Nga NDI: Shefki Kastrati

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj, Lule Ymeri.

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit.

Komisioni zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Shqyrtimi i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës,**
- 4. Shqyrtimi i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë,**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës:

Rendi i ditës u miratua pa plotësime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar:

Gjylnaze Syla - Kërkoj që në procesverbalin e mbledhjes së kaluar të ceket fakti se ajo vullnetarisht ka pranuar të jetë raportuese e Komisionit për **P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës.**

Mimoza Ahmetaj - Gjithashtu kërkoj që në procesverbalin e mbledhjes së kaluar të ceket fakti që ajo vullnetarisht ka pranuar të jetë raportuese e Komisionit për **P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës.**

Meqë nuk të tjera, procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua vetëm me këto vërejtje.

3. Shqyrtimi i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës

Sadik Idriz - Tha se për P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës, raportuese e kemi Gjylnaze Sylën, që e dorëzoi raportin. Ajo gjithashtu do ta bëjë një prezantim me gojë të këtij raporti. E kemi edhe një shkresë nga Ombudspersoni lidhur me këtë projektligj, ndërsa nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, me ne janë Agim Millaku dhe Murat Vokshi.

Gjylnaze Syla - Kërkoj falje nga kolegët që nuk kishte arritur të organizohej më herët, në mënyrë që anëtarët e Komisionit ta kishin mundësinë ta lexonin më parë raportin. Duke e shqyrtuar Ligjin kishte parë se kishte nevojë ta konsultonte Ligjin themelor të punës, pastaj Ligjin për Inspektoratin e Punës, si dhe Ligjin për mbrojtjen në punë. Pra, është dashur një punë voluminoze. Ajo tha se mund ta bëjmë një përmbledhje dhe propozoi që Komisioni të vendosë se a do ta lexojë raportin dhe në një nga mbledhjet e ardhshme të debatohet. Tha se Komisioni duhet ta ketë një kronologji si është zhvilluar situata me këtë ligj dhe me këto propozime për ndryshime të këtij ligji. Raporti në hyrje ka të bëjë me historiatin e këtij ligji, duke filluar nga ligji bazik siç janë Ligji për punë, Ligji për Inspektoratin e Punës, më vonë edhe ndryshimet që janë prezantuar nga sponsoruesi në mandatin e kaluar, por që plotësisht nuk i ka kaluar procedurat dhe nuk është miratuar, gjegjësisht është miratuar vetëm në parim. Tani, në mandatin e tretë është sjellë i njëjti P/ligj, por pa asnjë ndryshim. Në pjesën tjetër ajo ka menduar se Komisioni duhet të fokusohet më shumë në çështjet kryesore, se çka është thelbi i këtyre ndryshimeve dhe çfarë efekti kanë këto ndryshime në Ligjin për Inspektoratin e Punës. Çështja kryesore në këtë P/ligj është krijimi i Agjensionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës. Ajo konsideron se është çështje kryesore, sepse të gjitha inspektoratet sipas ligjit janë çështje e Agjensioneve Ekzekutive, d.m.th. implementojnë politika të sektorit të caktuar të Qeverisë. Prandaj, mënyra që është propozuar që të jetë Agjension Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, nuk është më në funksion ose në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut për degën e Ekzekutivit, por me këto propozime merr rolin e një agjensionit të pavarur. Ajo mendon se kjo duhet të kthehet në sistemin e Inspektoratit ashtu siç është në botë. Koncepti i ri në botë është koncepti i integritimit, jo koncepti i formimit të agjensioneve të ndara dhe unike. Ajo theksoi se nuk mund ta kemi një projektligj të tillë, derisa nuk e kemi Ligjin për punë, sepse ai duhet të derivojë nga ai ligj dhe se ndryshimet në Ligjin për punë automatikisht do të kenë efekte në këtë ligj, që si tillë nuk mund të zbatohet. Qëllimi për të cilin është riproceduar ky ligj është se duhet të jetë më i qartë për shkak të zbatimit. Me formimin e këtij agjensionit, ajo konsideron se nuk do të arrihet ky qëllim. Pjesa tjetër ka të bëjë me çështje specifike, për të cilat ajo ka shkuar nën për nën me propozime konkrete, që ky komision duhet t'i shqyrtojë. Kryesisht të gjitha nënët kanë të bëjnë me themelimin e Agjensionit për Inspektoratin e Punës. Rekomandimet që ajo i ka dhënë, kanë të

bëjnë me sqarimin se çka është Inspektorati i Punës. Ai duhet të jetë një trup ekzekutiv i themeluar prej Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, por realisht me propozimet e dhëna nuk fuqizohet autoriteti i Inspektoratit. Ajo në raportin e saj ka cekur se agjensionet qeveritare kryesisht krijohen si mekanizma ndihmës të Qeverisë për zbatimin e politikave të Qeverisë në sektorin e caktuar. Ajo konsideron se duhet të pritet deri në kalimin e Ligjit të punës në mënyrë që të harmonizohet pastaj edhe me atë ligj. Kostoja e ligjit është mbi njëmilion që parasheh punëtorë dhe staf administrativ shtesë.

Sadik Idriz - Tha se pajtohet me atë që tha Gjylnaze Sylja dhe propozoi të dëgjohen përfaqësuesit e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe ky komision të mos merret me implikimet buxhetore, pasi me këtë do të merret Komisioni për Buxhet dhe Financa. Nëse Komisioni vlerëson se këto ndryshime duhet të bëhen, atëherë t'i përkrahim ato .

Murat Vokshi - Përfaqësues i Ministrisë theksoi se ekziston Ligji 2002/9, mirëpo në këtë ligj disa nene janë në kundërshtim edhe me vetveten, prandaj kanë propozuar disa ndryshime. P.sh.: në nenin 1, fushëveprimin e Inspektoratit të Punës, në nenin 3, autoritetin e Inspektoratit të Punës - tash Inspektorati i Punës si autoritet ekzekutiv. Rregullorja 2001/19, neni 3.1 pika a) lejon mundësinë e themelimit të agjensioneve nëse plotësohen dy kritere, si: të nxirret ligji dhe ta ketë buxhetin. Agjension do të thotë plotësimi i kritereve. Kriteret janë buxheti dhe ligji, këto të dyja ekzistojnë tek autoriteti i Inspektoratit të Punës. Ai para Komisionit për Inspektoratin e Punës e paraqiti një citat që ka ardhur prej Budapesti: Ministria e Punës është nismëtare dhe kujdestare për të gjitha ligjet për punë në vend. Agjencia e kësaj ministrie, merret me kontrollimin e zbatimit të Ligjit, ndërsa Shërbimi i Inspektoratit të Punës e ka përgjegjësinë e informimit të partnerëve socialë, si p.sh.: Oda Ekonomike dhe të gjitha palët e interesuara në lidhje me ligjet, sidomos në lidhje me të drejtat dhe detyrat e tyre. Sipas rastit ajo duhet t'i këshillojë dhe udhëzojë përpara se të përdorë sanksionet. Pastaj, ai theksoi se ky propozim ka bazë edhe në Konventën nr. 81 .

Agim Millaku - Theksoi se pikërisht aty ku janë paraqitur dualizmat kanë penguar në zbatimin e ligjit, qoftë të Ligjit themelor të punës, qoftë edhe të Ligjit për mbrojtjen në punë. Prandaj është një kundërshti e madhe që nuk e lejon nxjerrjen e një akti nënligjor për ta zbatuar Ligjin e marrëdhënieve të punës e jo këtë ligj, sepse ky ligj i përcakton vetëm kompetencat e inspektorit të punës dhe të stafit udhëheqës. Me Rregulloren 2001/19, mbi ekzekutivin, në nenin 3, parashihet që çdo institucion ekzekutues që themelohet me ligj dhe e ka vijën buxhetore të veten, e fiton të drejtën të quhet agjension. Duke i pasur parasysh këto dy kritere, Inspektorati i Punës është themeluar me Ligjin e vitit 2002/9 dhe e ka vijën buxhetore të veten. Që të mos ketë laramani, diku inspektorat i punës e diku autoritet, janë pajtuar të quhet agjension. Andaj çdo gjë që është paraparë në propozimin për plotësime dhe ndryshime të Ligjit për Inspektoratin e Punës, është bazuar në Konventën Ndërkombëtare nr. 81, në të cilën saktësohen më hollësisht roli dhe detyrat e Inspektoratit të Punës.

Gjylnaze Sylja - Theksoi se në Konventën e ILO-s, shumë qartë është paraparë çka është agjensioni akzekutiv. Propozimi i sponsoruesit e bën këtë agjension unik dhe nuk mbështetet në të gjitha ligjet për formimin e agjensioneve. Agjensioni është organ i Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale që për zbatimin e politikave të Ministrisë, nuk është agjension mbi agjensione. Ajo tha se, në të gjitha ligjet për inspektoratet e punës shkohet nga aspekti integruar. Pastaj theksoi se në botë synohet të zvogëlohet numri i inspektorëve dhe i stafit mbështetës. Sa i përket dy niveleve, ajo konstatoi se në ligj nuk kanë qenë dy nivele, shkalla e parë dhe shkalla e dytë dhe parashitroi pyetjen se në çka është mbështetur ky propozim dhe se ajo e përkrah një gjë

të tillë. Sipas saj, inspektorët komunalë do t'i zbatojnë kompetencat në suazat që ata i kanë dhe pastaj i raportojnë kryeinspektorit. U pajtua edhe me propozimin e bërë për emërim, që sipas saj duhet ta bëjë Këshilli për Emërimet Publike.

Armend Zemaj - Tha se ne i kemi ftuar përfaqësuesit e Ministrisë në mënyrë që të mund të nxjerrim ligje të zbatueshme. Pyetja e tij ishte se çka e bën më funksional ligjin për formimin e agjensionit, d.m.th çka është më funksionale: si inspektorat e çka si agjension? Mospropozimi ka të bëjë më të qenit agjension i pavarur, që është baza, sepse Komisionit i duhet arsyeshmëria e jo krahasimet që po bëhen këtu.

Flora Brovina - Tha se themelimi i agjensionëve në Kosovë është bërë epidemi. Ajo theksoi se në Kosovë ekzistojnë agjensione që janë themeluar pa ndryshimin e ligjeve ekzistuese dhe pa rekomandime nga Kuvendi, siç janë: Agjensioni për Barazi Gjinore, Agjensioni i Ushqimit, si dhe Agjensioni i Inspektoratit, që realisht ekzistojnë që nga viti 2003. Inspektorati i Punës si dhe Ministria, që në fillim kur është aprovuar Ligji për Inspektoratin e Punës, kanë pasur vërejtje që kanë qenë të drejtuara kryesisht për funksionimin e Inspektoratit të Punës në komuna. Pasi që me ligj po bëhet decentralizimi, atëherë Komisioni konsideron, që emërimi i këtyre inspektorëve të bëhet nga Ministria e jo nga komuna. Edhe ajo parashtrroi pyetjen, pse është e nevojshme të themelohet ky Agjension.

Murat Vokshi - Kërkoi nga anëtarët e Komisionit që ta konsultojnë Konventën Ndërkombëtare nr. 81, pastaj Ligjin nr. 2001/19 dhe tha se e gjithë kjo është bërë me qëllim që të mund të funksionojnë në terren. Organizimi i Inspektoratit të Punës është në nivel qendror dhe inspektorin komunal e ka zgjedhur Ministria, por sipas nenit 3.5 inspektorin komunal e zgjedh komuna. Për përfaqësuesit e Ministrisë me rëndësi është eliminimi i pengesave në praktikë, ndërsa fakti se a emërohet agjension apo autoritet nuk pengon.

Sadik Idriz - Falënderoi përfaqësuesit e Ministrisë për shpjegimet e tyre dhe theksoi se Komisioni do të vazhdojë të punojë gjatë shqyrtimit të raportit të përgatitur nga Gjylnaze Sylja. Pastaj vlerësoi se ndoshta Komisioni do ta presë Ligjin e Punës që është ligj bazik. I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur më atë se Qeveria në përfundim të mandatit të shkuar ka pasur një vendim që të mos formohen agjensione të reja. Do të kërkojë nga Qeveria mendimin, se a është e nevojshme të formohen agjensione të reja, sepse ka shumë agjensione që janë formuar e nuk kanë leje që të veprojnë si agjensione. Inspektorati është autoritet ekzekutiv, por nuk do të thotë që çdo autoritet ekzekutiv të jetë edhe agjension.

Mimoza Ahmetaj - Propozoi që Komisioni të presë dhe të marrë qëndrim zyrtar nga Qeveria lidhur me agjensionin dhe pastaj të harmonizohen qëndrimet me këtë që propozon Ministria dhe me propozimet e përgatitura nga raportuesja.

Sadik Idriz - Tha se nuk mund t'i presim qëndrimet e Qeverisë, meqë ne po bëjmë ligje. Anëtarët e Komisionit do t'i lexojnë ato që i prezantoi Gjylnaze Sylja dhe secili mund t'i japë mendimet e veta dhe pastaj të fillohet me amendamentet.

4. Shqyrtimi i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Sadik Idriz - Tha se për P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës

sociale në Kosovë janë dy raportuese, Mimoza Ahmetaj dhe Nurishahe Hulaj, prandaj ua japim fjalën .

Mimoza Ahmetaj - Tha se Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë ekziston që nga viti 2003, por për shkak se punëtorët socialë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjithnjë kanë hasur në vështirësi në terren, është parë e arsyeshme që ky ligj të ndryshohet. Për këtë arsye në vitin 2007 Ministria ka organizuar debat me punëtorët nga qendrat për punë sociale, që janë nja tridhjetë në gjithë territorin e Kosovës. Nga informatat që ajo ka mbledhur nga Banka Botërore dhe nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale del se 15% e popullatës në Kosovë jeton në varfëri të skajshme, ndërsa 45% në varfëri të përgjithshme. Ndhimat sociale që merren mbulojnë vetëm 13% të popullatës së varfër, ndërsa në forma të ndryshme të pensioneve mbulohet 6% e popullatës së Kosovës. Çmimet e shportës familjare nga viti i kaluar janë rritur për 50%. Numri i familjeve që marrin ndihmë sociale, vetëm gjatë vitit 2007, sillet nga 37.170 deri në 40.579. Me shumën e mjeteve që ndahen për ndihma sociale plotësohen 25% të nevojave mujore të një familjeje. Vështirësitë për aplikimin e ligjit janë: limitimi i buxhetit, dokumentet jounike të të gjitha gjykatave në Kosovë, që në Ministri paraqesin dilema se çka konsiderohet zyrtare e çka jozyrtare. Çështja e trashëgimisë së parregulluar e pronës, mungesa e ligjit, mungesa e ndihmave për të hendikepuarit, shporta familjare, që nuk dihet sa është tani në Kosovë, çmimet në rritje, shpenzimet administrative komunale për nxjerrjen e dokumenteve, si dhe mungesa e njohurive për bonitetin e tokës në Kosovë, janë disa nga vështirësitë. Me ligj parashihet që një aplikues, që ka 0.5 ha tokë, nuk ka të drejtë në ndihma sociale, ndërkaq boniteti i tokës në tërë Kosovën nuk është i njëjtë. Me këtë ndryshim dhe plotësim në Projektligj do të bëhet aq sa është e mundur të ndryshohen dispozitat kontradiktore, të pazbatueshme, të paqarta, konfuze dhe jofunksionale. Nga ndryshimet në Projektligj parashihet se do të kursehen 3 milionë euro dhe implementimi i këtij ligji nuk kërkon mjete shtesë. Ajo nuk ka shkuar nën për neni, sepse ka bërë një përmbledhje se çka duhet të përfillet. Sipas saj në radhë të parë duhet të bëhet analiza, të caktohet sa janë shpenzimet mesatare të një familjeje, të caktohet shporta familjare që do të kërkohet nga Ministria për Financa dhe në bazë të kësaj të bëhet rritja e ndihmave jo vetëm për 5 euro, sa parashihet me këtë Projektligj, por në varësi nga çmimet që janë rritur për shportën familjare. Këtë e arsyetoj me faktin se rritja për 5 euro është bërë në vitin 2007, ndërsa nga viti 2007 deri sot çmimet e ushqimeve kanë pasur rritje mbi 50%. Te shikohet mundësia që të mos ndërpritet ndihma sociale për fëmijët 5-vjeçarë. Pasuria e tokës të vlerësohet sipas bonitetit e jo sipas sipërfaqes. Jo çdo herë rasteve me veturë t'u ndërpritet ndihma sociale, sepse ka raste kur familje me anëtarë të hendikepuar e kanë të domosdoshme veturën për shërbime familjare. Të respektohet Konventa Ndërkombëtare ku fëmijë konsiderohen personat deri në moshën 18-vjeçare. Te prindi vetushqyes mosha e fëmijës që merr ndihma sociale të jetë deri në 18 vjet. Gjate ndarjes së ndihmës sociale nga Komisioni të jetë e pranishme edhe pala, jo të merret vendimi vetëm me dokumentacion. Shkalla e paaftësisë të zbritet nga 80% në 60%. Të autorizohen drejtoratet e QPS-së për ndihmë emergjente dhe jo çdo herë të jetë Ministria ajo që vendos për ndihmë emergjente. Riaplikimi për ndihmë të jetë për çdo vit dhe jo për çdo gjashtë muaj. Në rastet kur kemi të bëjmë me të sëmurë mendorë, që nuk kanë dokumentacion për pension, për persona me aftësi të kufizuar, atëherë t'u jepet ndihmë sociale. Të praktikohen gjambat për dëshmi të rreme dhe obstrukcione, ashtu siç parashihet me Ligj, neni 10, pikat 1 dhe 2, që deri më tani nuk është aplikuar në praktikë.

Nurishahe Hulaj - Tha se Ligji për skemën e ndihmës sociale ka qenë bazik për t'u ndihmuar qytetarëve të Kosovës që kanë pasur nevojë. Me atë ligj nuk janë plotësuar kërkesat e qytetarëve për ndihmë sociale meqë Buxheti i Kosovës është shumë i varfër dhe se diku 60% e popullatës është e papunë, prandaj është propozuar ndryshimi dhe plotësimi e Ligjit për skemën e ndihmës

sociale. Ajo ka prezantuar përmbledhjen që ka përgatitur lidhur me këtë P/ligj . Një pjesë e kërkesve të skemës së ndihmës sociale sipas këtij Projektligji nuk do të mund të marrë ndihma sociale për shkak të futjes së kriterëve të reja. Për shkak të ndikimeve buxhetore është paraparë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për skemën e ndihmës sociale. Tani janë 40.000 shfrytëzues të skemës së ndihmës sociale. Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të skemës së ndihmës sociale reduktohen në 33,569 familje dhe kursehen 3.3 milionë euro në vit. Është theksuar se Ligji për skemën e ndihmës sociale ka qenë konfuz, me dispozita kontradiktore, që kanë krijuar vështirësi në implementimin e vet ligjit. Ajo ka shkuar amendament pas amendamenti dhe propozoi që të gjithë anëtarët e Komisionit të paraqesin amendamente konkrete që pastaj të mblidhen dhe të harmonizohen. Ajo çka është thelbësore, sipas saj, është se disa çështje rregullohen me ligjin e ardhshëm për statusin dhe për të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve të luftës, të pjesëtarëve të UÇK-së dhe të familjeve të viktimave civile. E rëndësishme në këtë ligj është se shumë çështje rregullohen me udhëzime administrative, por që nuk sqarohen çfarë udhëzimesh janë, afati kohor dhe kur do të nxirren ato udhëzime.

Teutë Hadri - Propozoi të shkohet konkretisht me amendamente pasi që Komisioni të marrë opinionet e përfaqësuesve të Mistrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Sadik Idriz - Propozoi që të dëgjohen përfaqësuesit e Ministrisë.

Fadil Rracaj - Pasi përshëndeti anëtarët e Komisionit e bëri një prezantim të përgjithshëm për P/ligjin. Tha se ekziston Ligji për skemën e ndihmës sociale që nga viti 2003, por ka pasur kërkesa dhe propozime për ndryshimin dhe plotësimin e tij për shkak se disa dispozita të këtij ligji janë konfuz, kontradiktore dhe jofunksionale që kanë ndikuar në mospërzgjedhjen e drejtë të familjeve për ta shfrytëzuar ndihmën sociale. Në përputhshmëri me këto kërkesa dhe propozime të qendrave për punë sociale që merren me administrimin e ndihmave sociale, si dhe në përputhje me parimet dhe kriteret që janë të përcaktuara me rregullore për punën e Qeverisë së Kosovës, Departamenti i Mirëqenies Sociale ka marrë nismën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale. Qëllimi i këtij P/ligji është krijimi i një rrjeti të mbrojtjes sociale në bazë të kriterëve të mirëfillta ligjore. Ai tha se me këto plotësime e ndryshime do të arrihen disa objektiva si: kursimi i mjeteve buxhetore, përzgjedhja e drejtë dhe e ligjshme e familjeve për shfrytëzimin e ndihmave sociale, rritja e shumës së ndihmave sociale për 5 euro, si dhe eliminimi i disa familjeve nga shfrytëzimi i ndihmave sociale që kanë qenë shfrytëzuese si rezultat i kriterëve jo të mirëfillta ligjore.

Armend Zemaj - Përgëzoi përfaqësuesit e Ministrisë për memorandum shpjegues shumë të mirë. Ai propozoi të saktësohen amendamentet, ndërsa sa u përket kategorive të familjeve që duhet të marrin ndihmë sociale të bëhen ndryshimet në Projektligj në mënyre që sa më mirë të rregullohet kjo çështje.

Qamile Morina - Tha se ka qendra për punë sociale, por nuk ka mundur të hasë në ligj si është përcaktuar veprimtaria e tyre ose ndoshta kjo është përcaktuar me ndonjë udhëzim administrativ, si dhe kush duhet ta kryejë këtë veprimtari në këto qendra.

Ndërsa me pyetjen e dytë, u interesua se ku do të shpenzohet buxheti i kursyer sipas këtij Projektligji. Në cilat çështje? A do të shkojë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës? A do të mbetet në avancimin e MPMS-së ose a do të rritet nga këto kursime ndihma për këto familje?

Flora Brovina - Pajtohet që sot të mos debatohet për Ligjin, por të mblidhen informacione nga përfaqësuesit e Ministrisë. Ajo pyeti përfaqësuesit e Ministrisë se a ka nevojë për ndryshime të

tjera në këtë P/ligj, përveç asaj që është propozuar në mandatin e kaluar, sepse Projektligji ka qenë edhe në mandatin e kaluar dhe tani ka filluar edhe zbatimi i Ligjit për pjesëtarët e UÇK- së. U interesua a ka mbetur dikush jashtë këtij ligji që mund të futet tani në Ligjin e skemës së ndihmës sociale.

Fadil Rracaj - Tha se Pprojektligji është proceduar më 2007 dhe është riproceduar edhe në këtë legjislaturë. Domethënë ky P/ligj nuk është kthyer fare te sponsoruesit, por nga Qeveria është riproceduar në Kuvend. Kur flitet për kategoritë e dala nga lufta, nuk duhet te përfshihen në këtë ligj, pasi që për këto kategori është ligji i posaçëm që po zbatohet aktualisht.

Fehmi Ibrahim - Tha se propozimet nga MPMS-ja rrjedhin nga një debat i gjerë që ka pasur Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale në qendrat për punë sociale, ku janë tri shërbime: Shërbimi i Ndhimave Sociale, Shërbimet Sociale dhe Shërbimi Administrativo-Financiar. Punën e skemës së ndihmave sociale e menaxhon Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, ndërsa administrimin e bëjnë qendrat për punë sociale. Me propozimin që e kanë bërë kanë konsideruar që një pjesë e mjeteve të shkojë në ngritje të ndihmave sociale. Neni 4.1 ka pasur paqartësi dhe me propozim kanë kërkuar që të qartësohet .

Gjylnaze Syla - Pyeti se përpos arsyes së paqartësisë së disa dispozitave, cilat janë arsyet e tjera për ndryshimin e Projektligjit. Ligji do të ishte më i qartë dhe më i zbatueshëm, jo vetëm me vënien e kritereve të reja dhe me saktësimin e tyre, por edhe me zbatimin e udhëzimeve administrative dhe me përcaktimin e afatit kohor për nxjerrjen e tyre.

Fadil Racaj - Tha se ligji bazë ndoshta është i vetmi ligj pas lufte që ka një rregullore të zbatueshme me të cilën hollësisht rregullohet zbatimi i Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë. Ai theksoi se ekzistojnë edhe disa udhëzime administrative për zbatimin sa më të mirë të Ligjit .

Sadik Idriz - Tha se në mbledhjen e ardhshme do të shqyrtohen amendamentet dhe do ta kemi Ligjin të përfunduar me amendamentet e propozuara.

Mbledhja e radhës, të martën e ardhshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:55.

Përgatiti
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz
